REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E DREJTËSISË**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT**
**DREJTORIA E INSPEKTIMIT**

Nr. 1617 prot. Tiranë, më 28.09.2026

**VENDIM**
**Nr. 79, Datë 28/09/2026**

**"PËR**
**MIRATIMIN E INSPEKTIMIT "PEZULLIMI I ÇËSHTJEVE PËRMBARIMORE, KONFORM NENIT 615/DH TË KPC, NGA ZYRA PËRMBARIMORE GJIROKASTËR, SARANDË, FIER, DURRËS"**

Në zbatim të nenit 8, pika c të Ligjit nr. 8/2023 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror*", Urdhrit nr. 53 Prot., nr. 06, datë 12.01.2026 "Për miratimn e Planit të Zhvillimit të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror" të Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarimit, Urdhrit nr. 159/3 Prot., nr. 68, datë 20.06.2025 "Për miratimin e Metodologjisë së Inspektimit të Veprimtarisë së Përmbaruesve Gjyqësorë Shtetërorë", i ndryshuar, Vendimit nr. 77 Prot., nr. 03, datë 13.01.2026 "Për miratimin e Planit Vjetor të Inspektimeve për vitin 2026" të Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarimit, Planit të Punës për inspektimet nr. 77/1 Prot., datë 23.01.2026,

**VENDOSA:**

1. Miratimin e inspektimit "Pezullimi i çështjeve përmbarimore, konform nenit 615/dh të KPC, nga Zyra Përmbarimroe Gjirokastër, Sarandë, Fier, Durrës", që do të kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit, sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Ngarkohet Drejtoria e Inspektimit për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse për njoftimin dhe publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**ERGYS QIRICI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT MINISTRIA E DREJTËSISË TIRANË



Scanned with CamScanner

Inspektimi institucional me temë "*Pezullimi i çështjeve përmbarimore, konform nenit 615/dh të KPC, nga Zyra Përmbarimore Gjirokastër, Sarandë, Fier, Durrës*",

| **Objekti i inspektimit** | **Metodologjia e inspektimit** | **Dokumentat që do të inspektohen** | **Kohëzgjatja e inspektimit** | **Afati i dorëzimit të raportit** |
|---|---|---|---|---|
| Njoftimet e palës kreditore për tu paraqitur apo për të kthyer përgjigje, të kryer nga përmbaruesi gjyqësor.<br><br>Pezullimi i ekzekutimit të urdhrit të ekzekutimit në zbatim të nenit 615/dh të KPC | Verifikim nëpërmjet kërkesave për informacion;<br>Me e –mail;<br><br>Me paraqitje fizike në zyrat përmbarimore sipas rastit,<br><br>- identifikimin e dosjeve përmbarimore për secilin përmbarues të cilat janë pezulluar në vitin 2024 - 2025<br><br>- marrjen e kopjeve fizike dhe të skanuara të akteve të dosjeve përmbarimore, kjo vlerësuar sipas rastit nga ana e inspektorëve;<br><br>Krahasimi i praktikës konkrete me kërkesat ligjore dhe nënligjore në fuqi | Dosjet përmbarimore të pezulluara sipas nenit 615/dh për 2024 - 2025 të zyrës përmbarimore, dhe çdo akt përmbarimore që gjendet në dosje.<br><br>Të dhënat statistikore ku janë pasqyruar të dhëna mbi dosjet e pezulluara për vitin 2024 dhe 2025<br><br>Çdo e dhënë tjetër që vlerësohet e domosdoshme nga grupi i inspektimit. | ZP Gjirokastër<br>ZP Sarandë<br>ZP Fier<br>ZP Durrës<br>09.10.2026<br>- 16.10.2026 | Grup i Inspektimit harton Projekt raportin e inspektimit brenda një afati 30 ditësh nga përfundimi i inspektimit.<br><br>Projekt Raporti i dërgohet Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarimit për miratim dhe më pas përcillet për objeksione pranë zyrave përkatëse.<br><br>Grupi i Inspektimit harton |



Scanned with CamScanner

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | Raportin përfundimtar të inspektimit brenda një afati 30 ditësh nga miratimi i Projekt Raportit.<br><br>Raporti përfundimtar dorëzohet për miratim pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarimit dhe më pas u njoftohet zyrës përmbarimore të inspektuar. |



Scanned with CamScanner